REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS
OPSTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
Nr.07/351/01-8069
Dt. 05.05.2017

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit duke vendosur sipas kërkesës së parashtruar nga: **Fejzullah (Xhafer) Llukaci** nga Gjakova, për dhënjen e Lejes së Ndërtimit për ndërtimin e objektit të kategorisë së parë, me destinim objekt i banimit individual, me etazhitet P+1, në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21 si dhe Ligjit për Procedurën Administrative Nr 02/L-28 nenit 11, bien këtë:

A K T V E N D I M

I. I LEJOHET: aplikuesit: Fejzullah (Xhafer) Llukaci nga Gjakova, ndërtimi i objektit të kategorisë së parë, me destinim objekt i banimit individual, sipas Projektit Kryesor të prezantuar, në përputhshmëri me Planin Rregullues Urban "Pjesa Lindore", si dhe Kushtet Ndërtimore me nr. 07-351-01-4530, dt. 23.03.2017, të lëshuar nga DUMM, në ngastrat kadastrale me nr. 4208-24 dhe 4208-25, Z.K. Gjakovë-J-Qytet, në rrugën "Mark Malota", në pronësi të lartëpërmendurit, e cila ka vijën e ndërtimit dhe rregullimit të definuar dhe të prezantuar në planin e situacionit me të gjithë parametrat tjerë përcjellës për ndërtimin e objektit në fjalë, etazhiteti i objektit është P+1, me sipërfaqe të përgjithëshme (bruto) të objektit **S=182.38 m².**

Përdhesa: (Sip,Bruto): S= 91.30 m²
Kati i parë: (Sip,Bruto): S= 91.08 m²

II. Hartimin e projektit me destinim: ndërtimi i objektit i objektit të banimit individual, nga pika 1 e këtij aktvendimi e ka bërë byroja projektuese "A&D Project" Prishtinë.

IV. Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është Plan Situacioni i lokacionit me objektin sipas vijës së ndërtimit dhe rregullimit, e përshkruar në situacionin grafik për të cilin është dhënë pëlqimi përkatës nga kjo drejtori i cili është bazë për rilevimin gjeodezik të objektit nga pika 1 e këtij aktvendimi.

V. Investitori është i obliguar:

- Që të ruaj një ekzemplar origjinal të dokumentacionit teknik në bazë të të cilit i është dhënë kjo Leje Ndërtimi;
- Që pa pëlqimin e hartuesit të projektit kryesor dhe pëlqimin e kësaj Drejtorie, të mos bëjë asnjë ndryshim në projekt;
- Ekzekutimi i punimeve nga pika 1 e këtij Aktvendimi, të realizohet nën mbikëqyrjen e organit mbikëqyrës për realizimin e ndërtimit të objektit.
- Të lajmëroj Drejtorinë e inspekcionit për ditën e fillimit të punës së paku 8(tetë) ditë para fillimit të ndërtimit,me qëllim të verifikimit dhe përcjelljes së punimeve:

VI. Kjo Leje Ndërtimi vlen 1(një) vit nga dita e lëshimit të këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Fejzullah (Xhafer) Llukaci nga Gjakova, me banim në rrugën "Mark Malota" ka parashtruar kërkesën pranë DUMM me nr. 07/351/01-8069 të datës 11.04.2017 për dhënjen e Lejes së Ndërtimit për ndërtimin e objektit të kategorisë së parë, me destinim objekt i banimit individual, me etazhitet P+1, në ngastrat kadastrale me nr. 4208-24 dhe 4208-25, Z.K. Gjakovë-J- Qytet, në rrugën "Mark Malota", siq është përshkruar në pikën 1 të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Së bashku me kërkesën investitori e ka prezantuar edhe këtë dokumentacion:

1. Planin e Situacionit në përpjesë 1:500 të datës 13.03.2017, të punuar nga "GEO-REJ"SHPK.
2. Kopjen e planit të datës 24.03.2017 në pronësi të Fejzullah (Xhafer) Llukaci nga Gjakova, të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
3. Çertifikaten mbi të drejtën në pronën e paluajtshme (fotokopje) me nr.të lëndës 1706/17, të datës 24.03.2017, të lëshuara nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
4. Kushtet Ndërtimore, me nr. 07-351/01-4530, të datës 23.03.2017, për rregullimin e hapësirës për ndërtimin e objektit të banimit individual, në ngastren kadastrale me nr. 4208/24 DHE 4208/25, ZK: Gjakove-J-Qytet, të lëshuar nga DUMM.
5. Pëlqimin për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, me nr.08-320-01-7458/17, dt.04.04.2017, nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.
6. Vërtetimin mbi kryerjen e obligimeve nga tatimi në pronë, nr 430-B-112 të datës 02.03.2017.
7. Pëlqimin nga KEDS-Gjakovë, të datës 27.03.2017.
8. Pëlqimin nga K.R.U."Radoniqi"Sh.A.Gjakovë, nr.931, 29.03.2017.
9. Pëlqimin nga PTK-Gjakovë, dt. 02.05.2017.
10. Vërtetimin nga KRM"Çabrati", nr.244, dt.24.03.2017.
11. Dëshminë mbi kryerjen e obligimeve nga taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit në PTK , filiala Gjakovë me datë 13.04.2017.
12. Projektin kryesor në 3 (tri) kopje, byroja projektuese "A&D Project" Prishtinë.

Taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit është paguar në vlerën prej 860.00 Euro.

KËSHILLË JURIDIKE:
Kundër këtij Aktvendimi,pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor në Prishtinë, dhe e njejta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.

Aktvendimi i dorëzohet:

- **Investitorit,**
- **Drejtorisë së Inspekcionit,**
- **Arhivës.**

Zyrtar i lartë për çështje juridike

Zenel Shabani.jur.dipl.

U. D. D r e j t o r i

Elida Bejtullahu, inxh.e dipl.e ark.

K.K. GJAKOVË
Z.K. Gjakovë J. Qytet
Parcella :4208-25,4208-24

PLAN SITUACIONI



Gjendja kadastrale

Gjendja faktike

LOKACIONI : FEJZULLAH LLUKACI

Gjakovë,
21.12.2017

Punoi: Fatmir Bobi tek.

Kontrolloi: Mirlinda Mullahasani I.D.A.

13 03 2017

Auto Cad 2012

P = 1 : 500

Punoi : "GEO-REJ"SH.P.K.
DREJTORI

Kuvendi Komunës GJAKOVË
Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë

KOPJE PLANI

Zona kad. Gjakovë J.Qytet

Poseduesi: Llukaci Fejzullah Xhafer

Veriu



Numri rendor i regjistrit të taksave kadastrale: _____

Nr. Parcelës	Plani	Vendi i quajtur	Kultura	Klasa	Sipërfaqja			Vërejtjet
					Ha	a	m²	
4208-24			arë	3		2	74	
4208-25			arë	1		1	50	
Gjithsejtë						4	24	

Që kjo kopje e planit është besnike e origjinalit të vet sipas gjendjes në kadastër duke paguar taksën sipas vendimit të KK GJAKOVË.

Gjakovë 24 03 të vitit 2017

Shk. zvog. 1:500

VËRTETON: